



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e njëmbëdhjete e rregullt e Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: **31.01.2023**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora **14:00**.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|--|------------------------------------|
| 1. <u>Enver Rugova, LDK;</u> | 14. <u>Nexhmedin Balaj, AAK;</u> |
| 2. <u>Hajrush Shoshi, LDK;</u> | 15. <u>Ajshe Metaj, AAK;</u> |
| 3. <u>Haki Podrimaj, LDK;</u> | 16. <u>Ardita Idrizaj, AAK;</u> |
| 4. <u>Faruk Kabashi, LDK;</u> | 17. <u>Negjdet Ramaj, AAK;</u> |
| 5. <u>Ruzhdi Metaj, LDK;</u> | 18. <u>Fjolla Ukaj, AAK;</u> |
| 6. <u>Faik Alushaj, LDK;</u> | 19. <u>Florin Dreshaj, VV;</u> |
| 7. <u>Veton Kurtaj, LDK;</u> | 20. <u>Niman Beqiraj, VV;</u> |
| 8. <u>Arta Balaj, LDK;</u> | 21. <u>Floriana Maxharraj, VV;</u> |
| 9. <u>Njomza Demaj, LDK;</u> | 22. <u>Lavdiqe Bujupaj, VV;</u> |
| 10. <u>Liridona Lajçi Avdiaj, LDK;</u> | 23. <u>Andi Xhuraj, PDK;</u> |
| 11. <u>Valbona Demaj, LDK;</u> | 24. <u>Visar Haxhijaj, PDK;</u> |
| 12. <u>Agron Gashi, AAK;</u> | 25. <u>Era Visoqi, PDK;</u> |
| 13. <u>Arianit Selmanaj, AAK;</u> | 26. <u>Melis Smakic, GIBL.</u> |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm: Kryetari i Komunës z. Ilir Ferati, Nënkyetari i Komunës, z. Ali Nimanaj, nënkryetari për Komunitete z. Valmir Rama, Drejtoret e Drejtorive, përfaqësues të OSBE-së, KFORI-të zyrtarë administrativ si dhe media lokale RTV – Fontana (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverballi dhe e njëjta gjendet në dosje: “shembulli 1”)

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-te e xhirimit gjenden në dosje: “shembulli 2”).

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar dhe publikuar drejtpërdrejt në youtube: <https://> : “shembulli 3”).

Mbledhjen e hapur dhe e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Enver Rugova.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Enver Rugova – përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje. Hap punimet për mbledhjen e njëmbëdhjete të rregullt të Legjislacionit të VII-të dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

Konstaton Kuorumin për mbajtjen e mbledhjes njëzet e pesë (26) anëtarë të Kuvendit janë të pranishëm.

Vazhdojmë me mbledhjen :

R E N D D I T E

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi i Raportit financiar për tremujorin e katër, tetor-dhjetor 2022,
4. Shqyrtimi i raportit të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2022,
5. Shqyrtimi i Raportit të punës së Kryetarit të komunës për vitin 2022,
6. Shqyrtimi i Raporti të punë së KKSB-së për vitit 2022,
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft - Planit të Veprimt për Transparencë 2023-2026,
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft - Strategjia për Komunikim dhe Informim 2023 - 2026,
9. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft - Planit Komunal për Integritet 2023 - 2026,
10. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim - Vendimit për Destinim e pronës për varreza në fshatin Zhakovë,
11. Shpallja në dëgjim publik e Projekt Rregullores për Menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Istogut,
12. Shpallja në Dëgjim Publik e Planit Strategjik për Trashëgimin Kulturore dhe Natyrore për komunën e Istogut 2023 -2027.
13. Pyetje nga anëtarët.

Në bazë të listës së nënshkrimeve dhe prezencës tuaj këtu prezent janë 26 të anëtarë të Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit - a ka dikush diçka nga anëtarët e kuvendit apo nga ekzekutivi.

Ne kemi një kërkesë nga anëtari i Kuvendit z. Niman Beqiraj

Niman Beqiraj – përshëndet të gjithë të pranishmit, duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, anëtari i kuvendit mund të propozoj shtimin e një pike në rend dite gjatë mbledhjes së rregullt të kuvendit të komunës nëse çështja që kërkohet të përfshihet është çështje urgjente dhe me rendësi publike kërkojmë nga ju kryesues të përfshini në rend të ditës këtë pikë.

Rekomandimin për faljen e tatimit në pronë për vlerën deri në 100 euro për të gjithë tatimpaguesit e Komunës së Istogut për vitin 2023, ata që deri me tani kanë të paguar t'ju llogarit para pagim për vitin vijues. I nderuar Kryesues i Kuvendit z. Rugova meqë

2

Procesverbali

ju si kryesues i kuvendit komunal konform Ligjeve në fuqi jeni garantues për mundësi të barabarte për të gjithë këshilltarët e komunës edhe ky propozim është në interes të të gjithë qytetarëve shpresoj që të gjej përkrahjen tuaj dhe të gjithë anëtarëve të tjerë të kuvendit. Me propozimin tonë që secilit tatimpagues ti falen nga 100 euro nga fatura e tatimit në pronë.

Kryesuesi i Kuvendit – a ka edhe dikush diçka?

Menaxheri i Prokurimit, z. Gëzim Ademaj – përshëndet të gjithë të pranishmit, propozon piken e ren për ren dite Njoftimi me Raportin e Kontratave të Prokurimit i vitit 2022.

Kryesuesi i Kuvendit – a ka edhe dikush diçka? Pasi qe nuk ka tjera propozime i nderuar z. Niman e kam pritur që do ta kërkoni që të hy kjo pikë e rendit të ditës sepse neper të gjitha kuvendet e komunave është propozuar por kjo nuk është përgjegjësi e komunave, është ligji për normat tatimore dhe ne si kuvend e kemi votuar këtu normat tatimore, ne nuk mund të ndërmarrim asgjë duhet ministria të marr një veprim të bëje ndonjë udhëzim Administrativ që ti udhëzoj komunat me e hekë nuk është kompetencë e komunave kjo.

Kryesuesi i Kuvendit - Hedh në votim rendin e ditës
Miratohet rendi i ditës për këtë mbledhje me 24 vota për dhe 2 kundër.
Konstatohet që me 26 anëtar janë prezent

Shqyrtimi i pikës 1.

Kryesuesi i Kuvendit- në mbledhje mungojnë z. Qerim Rexhaj, për shkaqe shëndetësore.

Shqyrtimi i pikës 2.

Kryesuesi i Kuvendit – Procesverbalin e keni pa a ka dikush ndonjë vërejtje.

Florin Dreshaj – nuk po përfshihet i gjithë fjalimi.

Hedh në miratim

Miratohet unanim

Konstatohet që me 26 vota për aq sa janë të pranishëm miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar i datës 29.11.2022.

Shqyrtimi i pikës 3.

Kryesuesi i Kuvendit - vazhdojmë me piken e radhës, Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt - Rregullores për Kategorizimin e Klubeve Sportive. A ka dikush diçka?

Nënkryetari i Komunës - përshëndet te gjithë të pranishmit, bën prezantimin dhe sqarimin e Projekt - Rregullores për Kategorizimin e Klubeve Sportive.

Agron Gashi - përshëndet te gjithë të pranishmit, kam dhen disa vërejtje të miat edhe mbledhjen e kaluar po e shohë se disa pika janë rregulluar dhe mirë që janë ndryshuar. Një nder pikat që e ka përmendur dhe po e potencoj prapë është pika të kriteret së pari të rangu ku pata propozuar që mos të jetë tradita e klubit me pikë me shumë se sa rangu sepse mendoj që është e padrejtë dhe nuk i motivon sportistet qe po kanë suksese. Të ndryshohet tradita te jete me 2 pik ndërsa rang 4 pikë të ndryshohet kjo.

Rezultatet e arritura tek klubet sportive është kompeticionet klubi i ligës dhe i super ligës që behet kampion i merr 10 pikë ndërsa klubi i kupës i merr 10 pikë janë të njëjta mendoj se këtu duhet me lëvizë p.sh kompeticioni i kupës luhet me tetë ndeshje, ndërsa ne superlig i ki 30 deri në 40 ndeshje dhe të jetë vlerësimi i njëjtë nuk bën.

Haki Podrimaj - përshëndet te gjithë të pranishmit, është një rregullore e mirë që komunës ju ka dashtë një e tillë, kam një vërejtje të neni 5 procedura e kategorizimit të klubeve sportive pika1, ku thotë 3 anëtar nga institucioni cili.

Hajrush Shoshi - përshëndet te gjithë të pranishmit, ka propozuar që drejtori të jetë kryesues i komisionit neni 5 pika 1.3 , sa i përket nenit 10 është rregulluar.

Ajshe Metaj - përshëndet te gjithë të pranishmit, sa i përket kësaj Rregulloreje është ber një punë shumë e mirë ne ketë drejtim , për here të par do të jete me transparente mënyra se si do të shpërblehem klubet sportive Rregullorja ka qenë. Të gjitha klubet i din kriteret se çka ju takon.

Nënkryetari i Komunës – bën sqarimet e pyetjeve.

Niman Beqiraj – propozojnë që komisioni të ketë përbërjen prej 7 anëtaresh e jo siç e keni përcaktuar me 5 anëtar.

Agon Dreshaj – përshëndet te gjithë të pranishmit, sqaron propozimet e dhëna ne mbledhje. Agron këto propozime që ju i thatë këto janë të ndryshuara në Rregullore. Formimi i komisionit neni 5 nuk mund të bllokojmë punët e ta vendosim si kusht vetëm drejtorin e është ligji dhe udhëzimet përkatëse për formimin e komisionit për ndarjen e subvencioneve.

Niman Beqiraj – neni 5 është me e rëndësishme ne gjithë ketë rregullore komisioni dhe kërkova që komisioni te jetë prej 7 anëtareve.

Kryesuesi i Kuvendit – hedh në votim propozimet e Agron Gashit, tradita ose rangimi të ndrrohen piket

Miratohet unanim nga anëtarët prezent 26 anëtar

Propozimi i dytë fituesi i super ligës 14 dhe fituesi i kupës se Kosovës 10

Miratohet unanim nga anëtarët prezent 26 anëtar

Hedhe në miratim propozimin e Hajrush Shoshi, që në komision për ndarjen e subvencioneve kryesues i komisionit të jetë drejtori i drejtoris

Miratohet unanim nga anëtarët prezent 26 anëtar

Hedhe në miratim propozimin e Niman Beqiraj , që komisioni të ketë përbërje prej 7 anëtarëve.

3 vota për, 15 kundër dhe 6 abstenim

Propozimi i Niman Beqiraj nuk miratohet nga anëtarët Kuvendit, prezent 26 anëtar

Kryesuesi i Kuvendit - a ka edhe dikush diçka pasi që nuk ka

Hedh në miratim

Miratohet nga anëtarët e Kuvendit me 23 vota për dhe 3 kundër.

26 anëtar prezent në mbledhje

Shqyrtimi i pikës së 4.

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me pikën tjetër, Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt - Rregullores për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatra, Vendbanime dhe Lagje Urbane në Territorin e Komunës së Istogut, Rregulloren keni pasur dhe keni pasur mundësi që ta shikon nëse ka dikush diçka urdhëroni?

Drejtori i Administratës, z. Arben Kabashi - përshëndet të gjithë të pranishmit, benë prezantimin dhe sqarimin e Projekt - Rregullores për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatra, Vendbanime dhe Lagje Urbane në Territorin e Komunës së Istogut

Kryesuesi i Kuvendit - a ka dikush diçka,

Hedh në votim

Miratohet unanim nga anëtarët e Kuvendit

Të pranishëm 23 anëtar të Kuvendit të Komunës

Shqyrtimi i pikës 5.

Kryesuesi i Kuvendit - vazhdojmë me pikën radhës Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt - Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha, edhe këtë rregullore e keni pasur dhe keni mundur ta shikoni nëse ka dikush diçka rreth saj urdhëroni?

Drejtori i Zhvillimit Ekonomik dhe Buxhet e Financa, z . Genc Ademaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, benë prezantimin dhe sqarimin e Projekt - Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha.

Agron Gashi - kam disa vërejtje dhe dua disa sqarime nga drejtorit përkatëse, Administrata dokumente jashtë vendit që paguhet me shumë ku është dallimi, të drejtorin për Kadastër e Gjeodezi është një taks që paguhet për fleta poseduese ku për

një hektar paguhet dikund rreth 150 euro shumë komuna tjera e kanë pezulluar këtë taksë për shkak të çështjeve ekonomike me e pezulluar këtë taksë të paktën për një vit. Vërtetimet të drejtorisë së Arsimit vërtetimet për nxënësit në shkollën fillore të hiqet pagesa. Të drejtorisë për shërbime publike asfalti po pritët dhe po mbetet ashtu komuna nuk e lejon ashtu me vepru ndërsa persona privat e prejnd dhe e len ashtu me e ber një inspektim. Parkingjet ku janë të ndara dhe si menaxhohen .

Drejtori i Zhvillimit Ekonomik dhe Buxhet e Financa, z . Genc Ademaj – jep sqarime rreth pyetjeve të parashtruara.

Drejtor për Kadastër dhe Gjeodezi, z. Agon Dreshaj – regjistrimi i pronës është e parapar me Udhëzim Administrativë, ndera pa pagës vetëm kur prona regjistrohen në emër të dy bashkëshorteve.

Hajrush Shoshi – taksë të drejtorisë Kulturë Rini e Sport dhënia në shfrytëzim e fushës së sportit për një muaj të hiqet, kjo duhet dhëne për orë.

Ajshe Metaj – vërtetimet për botën e jashtme pse kjo rritje e çmimit ? te pagesa e diftesave te jetë q euro pagesa jo 5 pse sht ngrit n 5 euro duhet t mbetet siç ka qen 1 euro.

Genc Ademaj – sqaron rreth pyetjeve nga anëtarët e kuvendit.

Florin Dreshaj – të neni 15 e kemi diskutuar edhe mbledhjen e kaluar, lirimi nga pagesat dhe taksat, të shtohet edhe familjarët e veteranëve të luftës.

Agron Gashi – të gjitha taksat po ngritën për qytetarin ne jemi këtu që t'ju dalim ne ndihmë qytetarëve.

Palestra e sportit është pa menaxhim është në gjendje të keqe të punësohet aty një roje dhe një pastrua për mirëmbajtjen e palestrës .

Kryetari i Komunës – jep sqarimin shqetësimet e anëtareve të kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit – e hedhim në votim propozimin e Hajrush Shoshi të neni 8 pika 2.5 taksë nga 3 euro të kthehet siç ka qenë 0.5 euro.

Miratohet unanim nga anëtarët e Kuvendit

24 anëtar prezent në mbledhje.

Hedhim në votim propozimin e Ajshe Metaj të neni 7 pika 3.7 taksë nga 3 euro të kthehet siç ka qenë 1 euro.

Miratohet unanim nga anëtarët e Kuvendit

24 anëtar prezent në mbledhje.

A ka dikush diçka?

Hedh në votim komplet Rregulloren për taksë ngarkesa dhe gjoba.

Miratohet unanim nga anëtarët e Kuvendit,

Konstatohet që 24 anëtar të Kuvendit janë prezent në sallë.

Shqyrtimi i pikës 6.

Kryesuesi i Kuvendit - vazhdojmë me piken e gjatë Shqyrtimi dhe miratimi i Listës së Veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2023, nëse ka dikush diçka rreth saj urdhëroni?

Drejtori për Kadastër dhe Gjeodezi, z. Agon Dreshaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, bën prezantimin dhe sqarimin e Listës së Veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2023.

Florin Dreshaj - pse në këtë listë nuk janë të përfshira të gjitha pronat komunale ?

Pas shumë diskutimesh mes anëtarëve të Kuvendit dhe ekzekutivit.

Kryesuesi i Kuvendit - a ka dikush diçka, pasi që diskutime tjerët nuk keni.

Hedh në votim

Miratohet nga anëtarët e Kuvendit të Komunës me 20 vota për dhe 4 kundër.

Konstatohet që 24 anëtar të Kuvendit janë prezent në sallë

15 minuta pauzë

Shqyrtimi i pikës 7.

Kryesuesi i Kuvendit - kalojmë në piken tjetër Njoftimi me Planin e Investiv në Infrastruktura e Ujësjellësit dhe Kanalizimit në Komunën së Istogut.

Drejtori i Hidro Drinit Istog, z. Bedri Hasanaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, bën prezantimin dhe sqarimin e Planit Investiv në Infrastruktura e Ujësjellësit dhe Kanalizimit në Komunën së Istogut.

Florin Dreshaj - ne emër të LVV e përshëndes këtë iniciativë, për njësoret kontrollues se ku po humb uji fatkeqësisht ka shumë nevojë, kjo është shumë e mirë por ish dashur të jetë edhe ndonjë inspektor me i kontrolluar deri sa të behën këto orët kontrolluese. Pyetja për impiantin në Baicë a ka me u funksionalizuar ky impiant.

Drejtori i Hidro Drinit Istog, z. Bedri Hasanaj - 80% të ujit kemi humbje është pasoj e gypave të vjetruar keqpërdorimit të ujit etj. Jep sqarime .

Nimon Beqiraj - pasi Kryetari dhe drejtori Hidro Drinit janë prezent dua ti pyes për projektin e mbi vadave deri ku ka shkuar projekti a është gati me përfunduar?

Drejtori i Hidro Drinit Istog, z. Bedri Hasanaj - Nima në atë projekt është punuar shumë është kapital nuk është në këtë planë...

Niman Beqiraj – ku është faji pse këto ngecje !

Kryetari i Komunës z. Ilir Ferati – sqaron realizimin dhe ecurinë e punës së projektit për ujë sjellësin e mbivades.

Ajshe Metaj – plani është gjithëpërfshirës dhe me këtë plani problematika çështja e ujit do të rregullohet. Të behet ndërrimi i gypave për shkak se uji po humb se gypat shumë të vjetër.

Ndërrimi i gypave të Asbestit nëse nuk ka mundësi me u ndërruar të gjitha duhet të bëjmë përpjeke sa me të madhe që me u ndërruar disa sepse Asbesti është kancerogjen, te jetë një vëmendje e posaçme të ndërrimi i këtyre gypave.

Drejtori i Hidro Drinit Istog, z. Bedri Hasanaj – ne kemi ber një hulumtim ne ndërrimin e gypave të vjetruar ku kryesisht janë në lidhesat ku janë edhe rrjedhat që duken të vogla dhe nuk dalin mbi sipërfaqe.

Gypat e Asbestit janë kancerogjen vetëm kur punohet me ta gypi i Asbestit kur laget e uj dhe krijon shtresën e ujit nuk është kancerogjen që 70 vite janë duke u përdorur ata gypa dhe ne kishim pasur pasoja të mëdha nga ajo punë. Nuk janë t mirë dhe duhet me i eliminuar prandaj janë të paraparë si projekt për me u eliminuar ata gypa.

Kryesuesi i Kuvendit - a ka edhe dikush diçka rreth kësaj pike?

Pasi që nuk ka kalojmë piken tjetër.

Konstatohet që me 22 anëtar të Kuvendit janë prezent në sallë

Shqyrtimi i pikës 8.

Kryesuesi i Kuvendit – vazhdojmë me piken tjetër Shqyrtimi dhe miratimi i Draft - Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027,

Drejtori i Shërbimeve Publik, z. Abedin Kabashi – përshëndet të gjithë të pranishmit, benë prezantimin dhe sqarimin e Draft - Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027.

Lavdije Bujupaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, deponia në fshatin Serbobran sa kia mundësi që këtë vite ajo depuni të largohet nga aty.

Ardita Idrizaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, të Rruga e bjeshkës Vrellë – Lubozhdë ka shumë mbeturina në atë rrugë, është një deponi e madhe .

Drejtori i Shërbimeve Publik, z. Abedin Kabashi –kjo deponi largimi i saj ka një kosto shumë të madhe dhe ne si komunë nuk mund ta largojmë. Në të ardhmen do planifikojmë mjete me shumë dhe ta hjekim atë deponi.

Kryesuesi i Kuvendit - a ka dikush diçka?

Hedh në miratim,

Miratohet unanim nga anëtarët e Kuvendit

Konstatohet që 18 anëtarë të Kuvendit janë prezent në sall.

Shqyrtimi i pikës 9.

Kryesuesi i Kuvendit- kalojmë piken e radhës Shpallja në diskutim publik e Draft - Planit të Veprimit për Transparencë 2023-2026, këtë lan e keni pasur a ka dikush diçka rreth tije.

Atëherë e hedh në votim,

Miratohet unanim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje

Konstatohet që 18 anëtar janë të pranishëm në sallë.

Shqyrtimi i pikës 10

Kryesuesi i Kuvendit - kalojmë piken e radhës pyetje dhe përgjigje. Shpallja në diskutim publik e Draft - Strategjia për Komunikim dhe Informim 2023 – 2026. këtë lan e keni pasur a ka dikush diçka rreth tije.

Atëherë e hedh në votim,

Miratohet unanim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje

Konstatohet që 20 anëtar janë të pranishëm në sallë.

Shqyrtimi i pikës 11

Kryesuesi i Kuvendit- kalojmë piken e radhës Shpallja në diskutim publik e Draft - Planit Komunal për Integritet 2023 – 2026. këtë lan e keni pasur a ka dikush diçka rreth tije.

Atëherë e hedh në votim,

Miratohet unanim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje

Konstatohet që 20 anëtar janë të pranishëm në sallë.

Shqyrtimi i pikës 12

Kryesuesi i Kuvendit- kalojmë piken e radhës Shfuqizohen Vendimet 00Nr. 144/2022 i datës 31.10.2022, Vendimi 00Nr.145/2022 i datës 31.10.2022 dhe Vendimi 00Nr.146/2022 i datës 31.10.2022. këto marrëveshja nga MAPL janë kthyer në rishqyrtim.

Florin Dreshaj – kërkesa ime është edhe nëse nuk ka qen praktik deri me tani, nga tash të na dërgohet konfirmimi i ligjshmërisë nga ministria, që kur të anulohet një vendim ta dimi pse po e anulojmë nëse ata nuk kanë pasur të drejt të bëjmë ankesë edhe ne.

Kryesuesi i Kuvendit- A ka dikush që dëshiron të diskutoj rreth kësaj pike?

Atëherë e hedh në votim,

Miratohet unanim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje

Konstatohet që 21 anëtar janë të pranishëm në sallë.

Shqyrtimi i pikës 13

Kryesuesi i Kuvendit- kalojmë piken e radhës Shfuqizohet vendimi 00Nr. 153/2022 i datës 31.10.2022 për ndarjen e mjeteve buxhetore për përkrahjen dhe funksionalizimin e Ndërmarrjes Publike "Stacioni i Autobusëve". Edhe këtë vendim e ka kthyer MAPL në rishqyrtim, a ka dikush diçka rreth kësaj pike.

Atëherë e hedh në votim,

Miratohet unanim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje

Konstatohet që 21 anëtar janë të pranishëm në sallë.

Shqyrtimi i pikës 14

Kryesuesi i Kuvendit- kalojmë piken e radhës Miratimi i Listës së dëmeve nga vërshimet e nëntorit, a ka dikush diçka rreth kësaj pike.

Udhëheqshi i Sektorit për Emergjencë, z.Skender Hasangjekaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, bën prezantimin dhe sqarimin e Listës së dëmeve nga vërshimet e nëntorit, a ka dikush diçka rreth kësaj pike.

Kryesuesi i Kuvendit - a ka dikush diçka rreth kësaj pike

Atëherë e hedh në votim,

Miratohet nga anëtarët e pranishëm në mbledhje me 13 vota për, 2 abstenime dhe 5 anëtar nuk marrin pjesë në votim

Konstatohet që 20 anëtar janë të pranishëm në sallë.

Shqyrtimi i pikës 15

Kryesuesi i Kuvendit- kalojmë piken e radhës Miratimi i Planit të Punës së KKSB-së për vitin 2023, a ka dikush diçka rreth kësaj pike.

Udhëheqshi i Sektorit për Emergjencë, (Koordinator i KKSB-së) z.Skender Hasangjekaj - bën prezantimin dhe sqarimin e Planit të Punës së KKSB-së për vitin 2023.

Kryesuesi i Kuvendit - a ka dikush diçka rreth kësaj pike

Atëherë e hedh në votim,

Miratohet unanim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje

Konstatohet që 17 anëtar janë të pranishëm në sallë.

Shqyrtimi i pikës 16

Kryesuesi i Kuvendit- kalojmë piken e radhës Shfuqizimi i Vendimit 01 Nr.23/2014 i datës 31.03.2014 për vend gjueti në Istog, a ka dikush diçka rreth kësaj pike.

Atëherë e hedh në votim,
Miratohet unanim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje
Konstatohet që 16 anëtar janë të pranishëm në sallë.

Shqyrtimi i pikës 17

Kryesuesi i Kuvendit- kalojmë piken e radhës Pyetje nga anëtarët përgjigje,


Ajshe Metaj - kam pyetje, dy të shtuna kemi punuar në shkolla të kompensohen profesorët për or shtesë.

Kryesuesi i Kuvendit- A ka dikush që dëshiron të diskutoj?
Konstatohet që 15 anëtar janë të pranishëm në sallë.

Falënderon të gjithë për durimin që patën, dhe kontributin e dhënë,
E shpallë të mbyllur mbledhjen e sotme. Faleminderit për pjesëmarrje, mirupafshim në mbledhjet e tjera.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 14:30

Procesmbajtëse,
Vjosa Hysenaj



Kryesues i mbledhjes,
Enver Rugova

